



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 30.12.2019)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 285, datë 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Korçë””.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 11:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Ilir Toska*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)
- 8. Erjon Muharremaj*** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brikena Ukperaj**, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli**, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. **Helena Papa**, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. **Krisulla Kasaj**, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.
4. **Valbona Bako**, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.
5. **Enida Muceku**, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.
6. **Erion Fejzulla**, USAID.
7. **Julinda Beqiraj**, EURALIUS.
8. **Elsma Shehu**, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
9. **Elisa Stamo**, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
10. **Anisa Brano**, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
11. **Mirjon Brahimllari**, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
12. **Flojera Davidhi**, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
13. **Rezart Alija**, EURALIUS.

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 285, datë 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Korçë””.

**Naureda Llagami:** Përsëndetje!

Po fillojmë me mbledhjen e radhës të datës 30 dhjetor 2019.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët, përveç zonjës Ukperaj e cila është me lejen e zakonshme dhe zoti Hallunaj i cili për arsye shëndetësore është në pamundësi për të qenë prezent në këtë mbledhje.

Siç jeni vënë në dijeni, dy janë çështjet që ne do marrim në shqyrtim në këtë mbledhje.

Çështja e parë ka të bëjë me miratimin e projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 285, datë 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Korçë””. Dhe projekt-akti tjetër është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përgatitur të dy projekt-aktet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Lidhur me relatimin e projekt-aktit të parë, fjalën ia jap zotit Toska.

**Ilir Toska:** Atëherë, kemi përgatitur një relacion për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 285, datë 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Korçë””.

Në fakt janë 3 çështje për të cilat do duhet të ndryshojmë këtë vendim.

Konkretisht, për çështjen penale në ngarkim të të pandehurës: {...}; e akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vjedhje” dhe “Ushtim prostitucioni”.

Për këtë çështje, mbi kërkesën nr. 1385 prot., datë 31.10.2019, të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktim gjyqtari për gjykimin një çështjeje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar këtë kërkesë, që është identifikuar si çështja nr. 10 (lëndë penale), akuza: “Vjedhje”, “Ushtim prostitucioni”, numri i gjyqtarëve që është kërkuar në atë rast, ka qenë 1, numri i kërkesës 1385 dhe numri i çështjes 1030.

Për këtë kërkesë të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, sikundër edhe për 9 çështje të tjera penale dhe 10 çështje civile, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të

përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të vendimit si më lart të KLGJ-së, si dhe mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është vendosur nga Këshilli që: Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 10 çështje penale, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa numri i gjyqtarëve, nga 3 prej secilës nga këto gjykata.

Pas zhvillimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e 3 gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe pas shortimit për shpërndarjen e 10 çështjeve penale, për çështjen si më lart është përzgjedhur gjyqtarja Vojsava Osmanaj, e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.258, datë 12.11.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, pika 10, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “10. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurës: {...}; e akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vjedhje” dhe “Ushttrim prostitucioni”.

Pikërisht ditën e këtij vendimi, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Korçë ka nisur për Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesën nr.1432 prot., datë 12.11.2019, për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, me të dhënat identifikuese si më poshtë... Në relacionin që është përgatitur mbi këtë kërkesë është përcaktuar si çështja nr. 20 (lëndë penale), objekti/akuza është “Vjedhje”, “Ushttrim prostitucioni”, nr. i gjyqtarëve që është kërkuar sipas kërkesës së dytë është 2 dhe numri i çështjes 130.

Ndërsa nuk i është bërë me dije, as në kërkesë, por as më vonë, se kërkesa si më lart kishte lidhje me kërkesën e mëparshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar edhe kërkesën e dytë.

Për këtë kërkesë të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, sikundër edhe për 28 çështje të tjera penale dhe 15 çështje civile, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e vendimit të tij “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit ka pranuar që: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 29 çështjeve penale, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa numri i gjyqtarëve të jetë 5 nga Gjykata e Apelit Tiranë, 2 nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 3 nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Pas zhvillimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe pas shortimit për shpërndarjen e 29 çështjeve penale, për çështjen si më lart janë përzgjedhur gjyqtarët Fatmira Hajdari dhe Andi Civici, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.285, datë 16.12.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, pika 20, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “20. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Fatmira Hajdari dhe Andi Civici, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurës: {...}; e akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vjedhje” dhe “Ushtrim prostitucioni”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Korçë, përmes shkresës nr.1593 prot., datë 24.12.2019, i ka bërë me dije dhe sqaruar Këshillin e Lartë Gjyqësor se për çështjen penale në fjalë, mbi dy kërkesat për caktim gjyqtari, ishin caktuar 3 gjyqtarë, ndërsa nevoja në këtë rast ishte vetëm për 2 gjyqtarë. Në këtë rast është sqaruar se në rastin e paraqitjes së kërkesës së dytë, por dhe as më vonë, Këshillit nuk i ishte bërë e ditur caktimi i 1 gjyqtari me vendimin e tij nr.258, datë 12.11.2019,

kështu që pas këtij vendimi, nevoja në fakt për atë çështje, nuk ishte për 2 gjyqtarë, por vetëm për 1 të tillë.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është vendi për ndryshimin e pikës 20, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, paragrafit I, të vendimit nr.285, datë 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket numrit dhe gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

II. Për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Keqtrajtim i të miturve, etj.”.

Mbi kërkesën nr.1383 prot., datë 31.10.2019, të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar këtë kërkesë, e cila është identifikuar si më poshtë: me nr. 7 në relacionin e përgatitur për shpërndarjen e çështjeve gjyqësore në muajin nëntor (lëndë penale), akuza: “Keqtrajtim i të miturve”, nr. i gjyqtarëve që kërkohen të delegohen 2, nr. i kërkesës 1383 dhe nr. i çështjes 197.

Për këtë kërkesë të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, sikundër edhe për 9 çështje të tjera penale dhe 10 çështje civile, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ai ka pranuar zbatimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit është pranuar që: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve penale, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa numri i gjyqtarëve, nga 3 prej secilës nga këto gjykata.

Pas zhvillimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e 3 gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe pas shortit për shpërndarjen e 10 çështjeve penale, për çështjen si më lart janë përzgjedhur gjyqtarët Aleks Nikolli dhe Selim Kryeziu, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.258, datë 12.11.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, pika 10, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “7. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Aleks Nikolli dhe Selim Kryeziu, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Keqtrajtim i të miturve, etj.”.

Pikërisht ditën e nesërme të këtij vendimi, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Korçë ka nisur për Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesën nr.1450 prot., datë 13.11.2019, për caktim gjyqtari për gjykimin një çështjeje gjyqësore të veçantë, me të dhënat identifikuese si më lart, ku në këtë rast ka kërkuar që të caktohen 3 gjyqtarë.

Ndërsa nuk i është bërë me dije, as në kërkesë, por as më vonë, se kërkesa si më lart kishte lidhje me kërkesën e mëparshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar edhe kërkesën e dytë.

Për këtë kërkesë të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, sikundër edhe për 28 çështje të tjera penale dhe 15 çështje civile, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ai ka pranuar zbatimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në bazë të së cilit është pranuar që: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 29 çështjeve penale, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa numri i gjyqtarëve të jetë 5 nga Gjykata e Apelit Tiranë, 2 nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 3 nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Pas zhvillimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe pas shortimit për shpërndarjen e 29 çështjeve penale, për çështjen si më lart janë përzgjedhur gjyqtarët Lindita Hoxha (relatore), Selim Kryeziu dhe Vojsava Osmanaj, të Gjykatës së Apelit

Shkodër.

Mbi këtë bazë, me vendimin Nr.285, datë 16.12.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, pika 27, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “27. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Lindita Hoxha (relatore), Selim Kryeziu dhe Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Keqtrajtim i të miturve, etj.”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, si dhe në rastin e parë, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Korçë, përmes shkresës nr.1593, datë 24.12.2019, i ka bërë me dije dhe sqaruar Këshillin e Lartë Gjyqësor se për çështjen penale në fjalë, mbi dy kërkesat për caktim gjyqtari, ishin caktuar 4 gjyqtarë, ndërsa nevoja në këtë rast ishte vetëm për 3 gjyqtarë. Në këtë rast është sqaruar se në rastin e paraqitjes së kërkesës së dytë, por dhe as më vonë, Këshillit nuk i ishte bërë e ditur caktimi i 2 gjyqtarëve me vendimin e tij nr.258, datë 12.11.2019, kështu që pas këtij vendimi, nevoja në fakt për atë çështje, nuk ishte për 3 gjyqtarë, por vetëm për 1 të tillë.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është vendi për ndryshimin e pikës 27, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, paragrafit I, të vendimit Nr.285, date 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket numrit dhe gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

III. Për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur, mbetur në tentativë”.

Mbi kërkesën nr.1382 prot., datë 31.10.2019, të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar këtë kërkesë, e cila është identifikuar si nevojë në atë rast, me nr. 5 (në lëndë penale), akuza: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur, mbetur në tentativë”, numri i gjyqtarëve që kërkohen të delegohen 2, numri i kërkesës 1382 dhe nr. i çështjes 202.



Për këtë kërkesë të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë, sikundër edhe për 9 çështje të tjera penale dhe 10 çështje civile, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisionit i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit ka pranuar zbatimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Konkretisht, është pranuar që: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve penale, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa numri i gjyqtarëve, nga 3 prej secilës nga këto gjykata.

Pas zhvillimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e 3 gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe pas shortit për shpërndarjen e 10 çështjeve penale, për çështjen si më lart, janë përzgjedhur gjyqtarët Aleks Nikolli dhe Selim Kryeziu, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.258, datë 12.11.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, pika 5, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Aleks Nikolli dhe Selim Kryeziu, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur, mbetur në tentativë”.

Pikërisht ditën e nesërme të këtij vendimi, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Korçë ka nisur për Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesën nr.1449 prot., datë 13.11.2019, për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, pikërisht për çështjen si më lart, ku në këtë rast ka kërkuar caktimin e 3 gjyqtarëve.

Ndërsa nuk i është bërë me dije, as në kërkesë, por as më vonë, se kërkesa si më lart kishte lidhje me kërkesën e mëparshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar edhe kërkesën e dytë, ku konkretisht për këtë kërkesë, sikundër edhe për 28 çështje të tjera penale dhe 15 çështje civile, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së

delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit ka pranuar zbatimin e vendimit të tij “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Konkretisht, referuar këtij vendimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar që: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 29 çështjeve penale, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa numri i gjyqtarëve të jetë 5 nga Gjykata e Apelit Tiranë, 2 nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 3 nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Pas zhvillimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe pas shortimit për shpërndarjen e 29 çështjeve penale, për çështjen si më lart janë përzgjedhur gjyqtarët Selim Kryeziu (relator), Lindita Hoxha dhe Vojsava Osmanaj, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.285, datë 16.12.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, pika 28, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “28. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Selim Kryeziu (relator), Lindita Hoxha dhe Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur, mbetur në tentativë”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, si dhe në rast që përmenda më sipër, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Korçë, me shkresën nr.1593 prot., datë 24.12.2019, i ka bërë me dije dhe sqaruar Këshillin e Lartë Gjyqësor se për çështjen penale në fjalë, mbi dy kërkesat për caktim gjyqtari, ishin caktuar 4 gjyqtarë, ndërsa nevoja në këtë rast ishte vetëm për 3 gjyqtarë. Në këtë rast është sqaruar se në rastin e paraqitjes së kërkesës së dytë, por dhe as më vonë, Këshillit nuk i ishte bërë e ditur caktimi i 2 gjyqtarëve me vendimin e tij nr.258, datë 12.11.2019, kështu që pas këtij vendimi, nevoja në fakt për atë

çështje, nuk ishte për 3 gjyqtarë, por vetëm për 1 të tillë.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është vendi për ndryshimin e pikës 28, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë”, paragrafit I, të vendimit nr.285, datë 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket numrit dhe gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Sa më sipër Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Ndryshimin e vendimit nr.285, datë 16.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, paragrafit I, nënndarja “Gjykata e Apelit Korçë” dhe konkretisht:

1. Ndryshimin e pikës 20 të këtij vendimi në këtë mënyrë:

“20. Gjyqtari apo gjyqtarja i/e Gjykatës së Apelit Tiranë, ai që do të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve Fatmira Hajdari dhe Andi Civici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurës: {...}; e akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vjedhje” dhe “Ushtrim prostitucioni”.

2. Ndryshimin e pikës 27 të këtij vendimi në këtë mënyrë:

“27. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, ajo që do të përzgjidhet me short midis gjyqtareve Lindita Hoxha dhe Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Keqtrajtim i të miturve, etj.”.

3. Ndryshimin e pikës 28 të këtij vendimi në këtë mënyrë:

“28. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, ajo që do të përzgjidhet me short midis gjyqtareve Lindita Hoxha dhe Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur, mbetur në tentativë”.

Ky është edhe propozimi i Komisionit, nëse jeni dakord me propozimin, do duhet të zhvillojmë tre shorte për të tre çështjet. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, jemi dakord me propozimin?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin.)*

Dakord.

Atëherë, vijojmë me procedurën e hedhjes së shortit elektronik.

**Ilir Toska:** Meqenëse Këshilli është dakord me propozimin e Komisionit, do duhet të zhvillojmë shortet për të tre çështjet.

Fillimisht për çështjen e parë.

**Valbona Bako:** Atëherë, për çështjen e parë nr. 130 është gjyqtare Fatmira Hajdari.

Për çështjen e dytë nr. 197 është gjyqtare Vojsava Osmanaj që do jetë edhe relatorja e çështjes, sipas propozimit.

Për çështjen e tretë nr. 202 është përsëri gjyqtare Vojsava Osmanaj e përzgjedhur.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit në lidhje me ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 285, datë 16.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Korçë”. Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 30.12.2019)*

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt:*** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 11:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                    |                                 |
|------------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>10. Naureda Llagami</i></b>  | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>11. Maksim Qoku</i></b>      | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>12. Medi Bici</i></b>        | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>13. Fatmira Luli</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>14. Brunilda Kadi</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>15. Ilir Toska</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>16. Alban Toro</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>17. Erjon Muharremaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>18. Marçela Shehu</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brikena Ukperaj**, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 5. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.**
- 6. Erion Fejzulla, USAID.**
- 7. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**
- 8. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 11. Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 13. Rezart Alija, EURALIUS.**

## **RENDI I DITËS:**

2. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek vendimi tjetër, tek hedhja e shortit. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Atëherë, fjalën e ka sërish zoti Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Atëherë, nga Gjykata e Apelit Vlorë janë dërguar 2 kërkesa urgjente për caktim gjyqtari në 2 çështje gjyqësore, të dyja janë në lëndë penale. Në një rast kërkohet caktimi i 1 gjyqtari ndërsa në një rast tjetër kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve.

Në këtë rast, zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit është i pamundur për shkak të padisponueshmërisë mungesë gjyqtari në skemë delegimi, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve, të jetë 3 ose 4, në varësi të shortit.

Në opion të pranimit të propozimit si më lart si dhe referuar edhe përbërjes së trupit gjykues, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Ndërsa për çështjen nr.2, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të cilët janë përzgjedhur me shortin e datës 19.07.2019, konkretisht gjyqtarët Enton Dhimitri (relator), Irena Brahimimi dhe Izet Salaj, ndërsa çështja aktuale është e njëjta me atë të mëparshmen, referuar edhe informacionit të dhënë nga zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Në këtë rast, propozimet vijuese janë për përjashtim nga shorti të kryetarit në

detyrë të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, zotit Dritan Banushi, si dhe për çështjen nr. 1 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë e cila është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht zonjë Miranda Andoni.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë, meqenëse Këshilli është dakord, do të vijojmë me procedurat e shortit për çështjen nr. 1, ndërsa për çështjen nr. 2 janë gjyqtarë të caktuar z. Enton Dhimitri (relator), Irena Brahimi dhe Izet Salaj (anëtarë).

**Valbona Bako:** Atëherë, për çështjen e parë gjyqtari i përzgjedhur – Irena Brahimi.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Apelit Vlorë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Nëse nuk keni ndonjë gjë për të thënë në mbledhje, atëherë mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**